

Worcester Public Schools 2021 Udhëzime për Diplomimin e Gjmnazit

Dyert do të hapen për diplomimin një orë përpara fillimit të ceremonisë.

Ju lutemi, vetëm të ftuar me bileta zyrtare do të lejohen të hyjnë. Në rast se bie shi, kujtohuni të merrni me vete një çadër!

Vendet për t'u Ulur, Maskat dhe Distancimi

Bazuar në udhëzimet e DESE, të ftuarit/at, të cilët/cilat nuk janë plotësisht të vaksinuar/a i këshillojmë të përdorin maska. Të gjithë/a të ftuarit/at janë veçanërisht të këshilluar/a të respektojnë distancën. Ata/ato të ftuar/a që nuk ndihen mirë apo janë duke përjetuar simptoma nuk duhet të marrin pjesë në mënyrë kategorike.

Transmetim i Drejtpërdrejtë & Regjistrim Video i Ceremonive

Polar Park do të transmetojë drejtpërdrejtë ceremonitë nëpërmjet faqes [WooSox Facebook page](#). WPS do të ritransmetojë këto video në Channel 11 (Kanali 11) dhe në [WEA-TV webpage](#).

Çanta

Çanta të vogla janë të lejuara, por që të gjitha **do të kontrollohen brenda standardeve nga personeli i sigurisë së Polar Park**.

Jo Bori/Tullumbace/Tabela apo Sende të tjera festive

Në përputhje me mënyrën se si janë organizuar ceremonitë e mëparshme të diplomimit në WPS, **ju kërkohet t'i lini këto sende në makinë**, për t'i përdorur pas ceremonisë.


Këpucët për të Diplomuarit/at

Nuk lejohen këpucë me taka apo me shollë shumë të lartë. Përveç faktit se mund të dëmtojnë terrenin jashtë, bari është shumë delikat dhe takat padyshim që do futen në tokë, mund të shkaktojnë edhe dëmtime fizike. Kjo masë është për arsye sa sigurie, aq edhe mirëmbajtjeje. **Polar Park do të ndajë shapka për ata/ato, këpucët e të cilëve/cilave nuk përputhen me udhëzimet tona, duke qenë se është një rregull që duhet ta ndjekim me përpikmëri.**

Parkimi

Më poshtë gjeni një hartë me zona parkimi në qytet që janë pranë me vendin e ceremonisë. Çmimet mund të ndryshojnë. Të gjithë/a të ftuarit/at dhe personeli duhet të përdorin vendet e parkimit 5-24, në hartën më poshtë.

NAME	TOTAL SPACES	EST 2021 AVAILABILITY
1. PLAYER PARKING	45	—
2. LEFT FIELD BUILDING GARAGE	100	—
3. NEW CITY GARAGE	349	—
4. TEMP. SURFACE LOT	100	—
5. LAMARTINE LOT	100	95
6. WASHINGTON/HARDING LOT	130	100
7. GREEN ST. LOT	30	20
8. WORCESTER ICE CENTER	330	300
9. WATER ST. LOT	34	20
10. YMCA LOT	105	46
11. MCGRATH (LIBRARY) LOT	289	200
12. MADISON PLACE LOT	279	140
13. RMV LOT	90	90
14. MYRTLE ST. LOT	130	80
15. MILLBURY ST. LOT	46	25
16. LANGDON ST. LOT	150	—
17. FEDERAL PLAZA GARAGE	511	375
18. UNION STATION GARAGE	500	280
19. WORCESTER COMMON GARAGE	560	400
20. GRAFTON ST. LOTS	254	165
21. AMTRAK/MBTA LOT	124	92
22. MERCANTILE CENTER GARAGE	1,646	800
23. WORCESTER PLAZA GARAGE	650	350
24. PEARL & ELM GARAGE	819	400
GRAND TOTAL	7,371	3,978



Pas Ceremonisë

Planifikoni të dilni menjëherë pas përfundimit të ceremonisë dhe të takoheni me fëmijët tuaj jashtë. Bazuar në udhëzimet e DESE, nuk janë të lejuara grumbullime apo festime.